PERSPEKTIVA PROFESIONALE

Revista e formimit profesional për prindërit dhe mësuesit
Numri 4 / Verë 2012

FOKUSI
ORIENTIMI PROFESIONAL

ROLET, PERSPEKTIVA, PËRVOJA

BERUFSBILDUNGPLUS.CH
RRUGA E PROFESIONISTËVE.
Një inciativë e konfederatës, kantoneve dhe organizatave të botës së punës.

NË FOKUS: ORIENTIMI PROFESIONAL

Do të bëhem diçka - por çfarë? Të rinjtë në moshën e orientimit profesional përballen me një pikëpyetje të madhe. Ata duhet të zgjedhin midis arsimit profesional bazë ose shkolles se mesme. **Ne kete pike atyre u vijnë në ndihmë prindërit, shkolla, këshillimi profesional dhe ekonomia.** Ky numër i revistës ju tregon se ç'rol luajnë këta 4 faktorë në procesin e orientimit profesional. Këtu përfshihen edhe të rinjtë që e kanë kaluar së fundmi me sukses procesin e orientimit profesional, si dhe prinder e keshillues profesionalë. Ne lidhje me kete: **baza orientuese, këshilla dhe faqe interneti** për një orientim të suksesshëm profesional.

Perspektiva profesionale – revista e arsimit profesional për prindërit dhe mësuesit – ju informon mbi perspektivat dhe mundësitë për karrierë që ofron arsimi profesional zviceran.



SHËNIME TË REDAKSISË
Botuesi: Zyra federale për formimin profesional dhe teknologjinë (ZFFPT), Effingerstrasse 27, CH-3003 Bern
Teksti: cR Kommunikation, Bern; Komma PR, Rolf Marti, Bern **Faqosja:** cR Kommunikation, Bern
Printimi: Albrecht Druck und Satz, Obergerlafingen
Përkthimi: Semantis Translation SA
Fotografitë: Titulli dhe faqja 2: © olly – Fotolia.com / Intervista dhe deklarata: zVg

NJË ÇËSHTJE PËR PRINDËRIT & TË TJERËT

ORIENTIMI PROFESIONAL

Cili profesion më përshtatet? Të rinjtë duhet ta gjejnë përgjigjen e kësaj pyetjeje gjatë klasës së 8-të e të 9-të – së bashku me prindërit, shkollën, këshillimin profesional dhe ndërmarrjet e praktikës.

Fëmijët e dinë me saktësi se çfarë duan të bëhen kur të rriten. Profesionistë futbolli, këngëtarë, astronautë, veterinerë... Ata mund të ëndërrojnë. Edhe të rinjtë që gjatë klasës së 8-të e të 9-të zgjedhin orientimin e tyre profesional mund të ëndërrojnë. Vetëm se ëndrrat e tyre duhet të përputhen me mundësitë reale. Profesionistë futbolli, këngëtarë? Ndoshta nuk mjafton vetëm kaq. Por për profesione si marangoz, nënpunëse, specialist shëndeti, polimekanike e shumë të tjera. Vendin e profesioneve të ëndrrave e zënë kështu profesionet e dëshiruar. Profesionet, të cilat u përshtaten të rinjve dhe përputhen me interesat dhe aftësitë e tyre si dhe me vendet e lira përkatëse të formimit profesional.

Sërish pyetja: Cili profesion më përshtatet? Shumë të rinj nuk e kanë të lehtë t'i përgjigjen kësaj pyetjeje. Atyre u duhet kohë për të qartësuar dëshirat, prirjet dhe aftësitë e tyre; u duhet të eksplorojnë botën e profesioneve e të mbledhin informacionet e nevojshme, së fundi u duhet të bëjnë një zgjedhje e të gjejnë një vend për praktikën mësimore (shih grafikun «Plani i orientimit profesional» faqe 4). E gjithë kjo nuk mund të bëhet vetëm. Të rinjtë kanë nevojë për mbështetje - nga prindërit, nga shkolla, nga këshillimi profesional dhe nga ekonomia.

Roli i prindërve

Prindërit kanë përgjegjësinë kryesore në procesin e orientimit profesional dhe u duhet të luajnë role të ndryshme, si atë të mentorit, të inkurajuesit, të ngushëlluesit, të përkrahësit, të instruktorit dhe të mikut të besuar. Jeni ju përgjegjësit për progresin e fëmijës tuaj gjatë procesit të orientimit profesional. Kur bëhet fjalë për të ndjekur një mësim orientues apo për të gjetur një vend për praktikën mësimore, jo rrallë vjen në ndihmë rrjeti i prindërve (punëdhënës, miq, të njohur). Vendimtar është fakti se fëmijët e ndjejnë angazhimin e prindërve të tyre, duke qenë kështu të gatshëm të dëgjojë idetë dhe pyetjet e tyre. Po aq e rëndësishme eshte edhe qe: Prindërit nuk duhet t'i vendosin fëmijët e tyre nën presion pa qenë e nevojshme. Procesi i orientimit profesional kërkon kohë dhe durim, si dhe qetësinë e duhur. Stresi rrallë herë të shpie drejt zgjidhjeve të mira.

Informacione për prindërit

Në kuadër të orientimit profesional, prindërit janë kujdestarët dhe ndikuesit më të rëndësishëm të fëmijëve të tyre. Më e rëndësishme është që ata të dinë se si zhvillohet procesi i orientimit profesional dhe se si duhet t'i mbështesin fëmijët e tyre në mënyrën më të mirë. Prindërit që duan të përgatiten posaçërisht për këtë rol, do të gjejnë materiale të shumta ndihmëse nga shtëpia botuese SDBB. Këta materiale mund të porositen në faqen e internetit www.shop.sdbb.ch (→ orientimi i parë profesional).

Roli i shkollës

Gjatë lëndës së orientimit profesional, të rinjtë mësojnë ta trajtojnë orientimin profesional në mënyrën më të mirë. Ata përballen me pritshmëritë dhe përfytyrimet e tyre, mbledhin informacione për profesionet dhe shkollat e mesme, mësojnë të shkruajnë aplikime si dhe përgatiten për biseda të mundshme prezantuese. Lënda e orientimit profesional fillon në vitin e dytë. Zakonisht mësuesit, së bashku me të rinjtë dhe prindërit, bëjnë një vlerësim të të rinjve. Shumë shkolla organizojnë edhe takime informuese për orientimin profesional.

Roli i këshillimit profesional

Këshillimi profesional u vë në dispozicion të rinjve shumë shërbime për orientimin profesional (shih intervistën në faqen 6). Këto shërbime janë zakonisht pa pagesë.

- Në **Qendrën e Informimit Profesional (QIP)** gjenden materiale të printuar ose elektronikë për **gjithë vendet e praktikës profesionale dhe vazhdimit të studimeve.** Këto materiale mund të huazohen e të studiohen në shtëpi së bashku me prindërit.
- Në **Internet** gjenden gjithashtu shumë informacione për çdo profesion, si dhe materiale ndihmëse për orientimin profesional: www.berufsberatung.ch.
- Në **këshillimet individuale,** të rinjtë që nuk i njohin prirjet dhe aftësitë e tyre ose që nuk vendosin dot mes shumëllojshmërisë së profesioneve, gjejnë mbështetjen e posaçme.

Roli i ekonomisë

Ekonomia e paraqet botën e punës dhe profesionet e saj në mënyrë realiste dhe të qartë - me anë të takimeve informuese, praktikave orientuese dhe vendeve të praktikës. Këto qasje janë të rëndësishme për të rinjtë, pasi as broshurat e as DVD-të nuk i zëvendësojnë dot përvojën dhe përshtypjet personale (shih kutizën «Praktikat orientuese» faqe 5).

Plani i orientimit profesional

Orientimi profesional zhvillohet gjatë dy viteve të fundit shkollore. Shtatë hapat e mëposhtëm kanë rezultuar të vlefshëm për të rinjtë.

Hapi 1: Njohja me interesat dhe pikat e forta
Vetëm nëse di se çfarë mundem dhe çfarë dua të bëj, do të gjej profesionin e duhur. Për këtë arsye do të zbuloj fillimisht pikat e mia të forta e të dobëta, prirjet dhe aftësitë e mia.

Hapi 2: Njohja me botën e punës dhe formimit profesional
Cilat janë profesionet që më interesojnë? Çfarë kërkesash kanë ato? Do të mbledh informacione e do të krijoj një ide të përgjithshme.

Hapi 3: Vlerësimi i interesave dhe pikave të forta kundrejt kërkesave
I njoh interesat dhe pikat e mia të forta dhe kam gjetur disa profesione tërheqës. Në cilat profesione përputhen aftësitë e mia me kriteret e profesionit?

Hapi 4: Vlerësimi i duhur i profesioneve interesante dhe formimit profesional
Tani dua ta di me saktësi: A më përshtatet vërtet ky profesion ose ai formim profesional? Unë po ndjek takime informuese, praktika orientuese dhe po bisedoj me njerëz nga bota profesionale.

Hapi 5: Vlerësimi i mundësive të ndryshme dhe zgjedhja
Kur të di se cilat profesione ose formime profesionale më përshtaten, do të marr një vendim. Ose do të vendos prioritete, nëse do të kem disa profesione ndër të cilat duhet të zgjedh. Do të më ndihmonte një listë me përparësitë dhe mangësitë.

Hapi 6: Marrja e vendimit
E kam marrë vendimin tashmë. Do të përgatis dokumentet e aplikimit, do të kërkoj një vend për praktikën mësimore ose do të regjistrohem në një shkollë të mesme.

Hapi 7: Përgatitja për praktikën ose shkollën
E kam gjetur vendin e formimit profesional. Kthim mbrapsht? Jo! Do të përgatitem për fazën e re të jetës, do të do të vazhdoj shkollën dhe do të plotësoj boshllëqet.

myBerufswahl.ch

Platforma interaktive e zgjedhjes së profesionit myBerufswahl.ch fokusohet tek shtatë hapat e zgjedhjes së profesionit dhe u drejtohet në masë të njëjtë nxënëseve dhe nxënësve, prindërve dhe mësuesve. Në çdo hap, grupet e synuara marrin informacionet dhe asistencën e posaçme.

Nxënësit do të gjejnë instrumente dhe lojëra interaktive që do t'i ndihmojnë të vlerësojnë interesat dhe aftësitë e tyre. Me një klikim të mouse-it mund të eksplorojnë degët e ndryshme të arsimimit dhe të informohen për formimet profesionale dhe profesionet e ndryshme. Gjithë njohuritë dhe informacionet i mbajnë në një libër identifikimi. Ky i fundit shërben si bazë për bisedat me mësuesit ose këshilluesit profesionalë. Për fazën e mëtejshme të procesit të orientimit profesional, studentët do të gjejnë udhëzime për kërkimin e vendeve të praktikës mësimore, për përgatitjen e bisedave gjatë një aplikimi e shumë të tjera.

Prindërit mund ta ndjekin procesin e orientimit profesional të fëmijëve të tyre. Çdo hap do të sqarohet e do të dokumentohet, në mënyrë që prindërit të dinë gjithmonë se në ç'fazë ndodhet fëmija i tyre, cilat detyra duhet të ndjekë ai dhe si mund ta ndihmojnë ata në këtë proces.

Mësuesit do të gjejnë materiale për lëndën e orientimit profesional si dhe shumë linke të dobishme. Përmes librit të identifikimit, ata mund të ndjekin e përkrahin zhvillimin e nxënëseve dhe nxënësve.

Orientimi profesional – Vështrim i përgjithshëm



Sipas çdo Kantoni mund të ketë ndryshime në kohë.
Drejtohuni në qendrat e këshillimit profesional në rajonin tuaj.
© myberufswahl.ch, SDBB

Një mjet ndihmës i rëndësishëm janë rikujtesat nëpërmjet e-mail: Të rinjtë, prindërit dhe mësuesit do të informohen rregullisht me e-mail se ç'hap kanë përpara. Në këtë mënyrë sigurohemi që plani i zgjedhjes së profesionit do të ndiqet e nuk do të harrohet asgjë e rëndësishme. Ata që nuk duan t'i lënë asgjë rastësisë në kuadër të zgjedhjes së profesionit, mund të logohen pa pagesë në myBerufswahl.ch.

Praktika orientuese

Një ushqim mund të duket shumë i shijshëm – ata që nuk e njohin, e nuhasin njëherë përpara se ta hanë. E njëjta gjë duhet të ndodhë edhe me orientimin profesional. Një praktikë mësimore (praktikë orientimi profesional) mundëson një përshtypje të parë të profesionit dhe botës së punës. Kjo praktikë zgjat dy deri në pesë ditë dhe zhvillohet në një ndërmarrje praktike. Të rinjtë njihen me përditshmërinë e një profesioni në shkallën 1:1, shohin nga afër profesionistët me përvojë dhe mund të fitojnë përvoja praktike.

Praktika mësimore lejohet vetëm nga 13 vjeç e lart. Më e mira është që të rinjtë të vizitojnë direkt ndërmarrjet e të pyesin atje për praktikat mësimore. Zgjidhje edhe më e mirë: Të zgjedhin atë ndërmarrje, në të cilën duan ta bëjnë praktikën mësimore. Ditët e praktikës mësimore do të tregojnë nëse një profesion i tërheq ose jo. Gjithashtu edhe vetë ndërmarrjet e praktikës mësimore shohin nëse të rinjtë përshtaten ose jo me ndërmarrjen. Nxënësit e praktikës mësimore janë nxënës të mundshëm. Ata që bëjnë shumë praktika mësimore, njihen me profesione dhe ndërmarrje të ndryshme - një bazë solide për vendimin e zgjedhjes së profesionit.

Jo gjithë profesionet mundësojnë praktika mësimore. Megjithatë, sërish mund të krijohen ide për botën përkatëse të punës. Për shembull nga takimet informuese të organizuara nga ndërmarrjet ose shoqatat profesionale, si dhe gjatë shoqërizimit për një ditë të tërë me profesionistë nga rrethi i të njohurve. Në një mënyrë a në një tjetër: Ai që do të kryejë një praktikë mësimore, duhet të jetë në kontakt me profesionin dhe të përgatitet mirë për këtë angazhim. Mënyrën se si bëhet kjo, e gjeni në www.berufsberatung.ch (› praktika mësimore) ose paketa e praktikës mësimore që gjeni në www.schulverlag.ch (› E-Services › Mediendatenbank › Artikelliste)*.

*gjermanisht

Një link për të gjitha rastet

www.berufsberatung.ch të shpie në të gjitha informacionet rëndësishme për orientimin profesional:
- Përshkrime pune dhe shkolla të mesme
- myBerufswahl.ch
- Praktika mësimore
- Takime informuese
- Certifikim i praktikës profesionale (Lena)
- Oferta kursesh të ndërmjetme dhe zgjidhje të ndërmjetme
- Këshilla për prindërit
- Informacione për të huajt
- Adresat e të këshillimit profesional (ose direkt: www.adressen.sdbb.ch)

INTERVISTA

«KËSHILLIMI PROFESIONAL NDIHMON NË KËRKIMIN E PRAKTIKAVE TË MUNDSHME PROFESIONALE»

Këshillimi profesional është një mbështetje e rëndësishme kur bëhet fjalë për orientimin profesional. Ku mund të ndihmojë dhe ku ndeshet me kufizime, do të na e sqarojë eksperti për këshillim profesional Marc Chassot*.

Kur është i nevojshëm dhe i dobishëm një këshillim profesional?
Këshillimi profesional, studimor dhe ai i karrierës është gjithmonë i dobishëm kur dikush gjendet përpara zgjedhjes së një profesioni apo formimi profesional, pavarësisht nga mosha. Kjo fazë vjen veçanërisht gjatë periudhave tranzitore në jetë ose në periudhën midis kohës së shkollës dhe formimit profesional ose në rastin e ndryshimit të një drejtimi profesional. Sipas nevojës për informacion, këshillimi mbulon ata njerëz që dëshirojnë të njihen me spektrin e mundësive aktuale. Ai ndihmon në qartësimin e ideve se cila zgjidhje përshtatet më mirë në një moment të caktuar, të arsimimit ose të karrierës profesionale.

Ç'dobi sjell këshillimi profesional?
Këshillimi profesional i ofron popullsisë shërbime informative: Në formë elektronike në faqen e internetit www.berufsberatung.ch si

dhe përmes dokumenteve të printuar në letër, të cilat ndodhen e mund të huazohen nëpër qendrat e ndryshme të informimit profesional. Dokumentacioni përkatës mund të porositet nëpër qendrat zvicerane për shërbimet profesionale të këshillimit për profesionet, studimet dhe karrierën SDBB. Këshillimi profesional ofron gjithashtu edhe këshillime individuale me këshillues profesionalë të diplomuar posaçërisht. Këshillimet organizohen në formën e bisedave. Pjesa më e madhe e shërbimeve bazë është pa pagesë, por disa kantone ofrojnë shërbime të tjera shtesë që janë me pagesë.

Ku kufizohet këshillimi profesional dhe deri ku mund të ofrohet ndihmë?
Këshillimi profesional nuk ndihmon në kërkimin e një vendi për praktikën mësimore. Kjo qendër nuk mund të mbështesë ndjekjen e një formimi profesional nëse vetë aplikantët nuk përmbushin kriteret e kërkuara nga vetë shkolla ose instituti arsimor. Procesi i këshillimit profesional kërkon pjesëmarrjen aktive të aplikuesit për këshillim profesional: Ky proces nuk ofron zgjidhje të gatshme, por ofron ndihmë në procesin e vendimmarrjes.

Me pak fjalë: Si rrjedh një vizitë në këshillimin profesional?
Biseda e këshillimit profesional fillon me paraqitjen e kërkesës nga personi që kërkon ndihmë: Cili është qëllimi i saj? Mbi ç'baza ngrihet biseda këshilluese? Më pas bëhet përmbledhja e përvojave dhe ecurisë shkollore të këtij personi. Së fundi, këtij personi do t'i kërkohet të rimendojë gjithë aspektet e zgjedhjes së ardhshme, ku bëjnë pjesë ndër të tjera interesat personalë dhe profesionalë, aftësitë dhe njohuritë e tij, mjedisi i tij, dëshirat dhe detyrimet e tij. Gjatë kësaj faze të bisedës mund të ofrohen edhe teste, nëse është e nevojshme. Këshilluesi profesional parashtron një sërë zgjidhjesh të mundshme dhe i analizon ato së bashku me personin aplikues. Ky proces ndihmon në arritjen e një vendimi, të cilin në fund personi aplikues duhet ta marrë vetë.

Në përfundim: Çfarë këshillash do t'i jepnit prindërve dhe mësuesve të të rinjve në procesin e orientimit profesional?
Prindërit dhe mësuesit luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e të rinjve gjatë orientimit profesional. Diskutimi duhet të bëhet sa më i hapur si në rrethin familjar ashtu edhe gjatë mësimit. Edhe pse mendimi i të rriturve nuk duhet të imponohet, sërish ai ndikon në arsyetimin e të rinjve për të ardhmen e tyre. Orientimit profesional lidhet shpesh me modele, me të cilët të rinjtë identifikohen. Prandaj, është e rëndësishme që të rriturit të jenë shembull përsa i përket vlerave themelore profesionale si dhe të shfaqin interes për profesionin e tyre.

* Marc Chassot, Shef Departamenti, Zyra e Këshillimit dhe Arsimimit të të Rriturve, Shteti Freiburg

Orientimi profesional

Kalimi në vitin e II të shkollës së arsimit të detyruar është vendimtar për fëmijën dhe prindërit. Hapi drejt formimit profesional çel shumë shtigje për të ardhmen.



KËSHILLA DHE UDHËZIME

Herë entuziastë e herë në dilemë mes ëndrrash e idesh - orientimi profesional është një proces i lodhshëm dhe i vështirë. Lexoni më poshtë se çfarë mund t'ju ndihmojë për marrjen e vendimit.

Dimitrios Lavantsiotis, inxhinier i kualifikuar impiantesh dhe aparaturash, punon si mjeshtër skenash në teatrin e Basel

Gjatë procesit të orientimit profesional, prindërit dhe mësuesit më kanë mbështetur shumë. Kështu, për shembull, mësuesi im ma dha idenë e inxhinierisë së impianteve dhe aparaturave. Prindërit më qëndronin gjithmonë pranë: me këshilla, udhëzime dhe sugjerime të dobishme. Por nuk më kanë vënë asnjëherë nën presion, duke më lënë ta merrja vendimin vetë.

Silvia Meister, punon si infermiere

Nga përvoja mund të them se procesi i orientimit profesional është i ndryshëm tek çdo fëmijë. Me të tre fëmijët e mi jam kujdesur gjithmonë që të praktikojnë në sa më shumë vende. Përvojat dhe përshtypjet e ndryshme ndihmojnë në marrjen e një vendimi. Më duket gjithashtu e rëndësishme që fëmijët të mos vihen nën presion si dhe të ndërgjegjësohen se zgjedhja e një formimi profesional është hapi i parë drejt botës së punës, por jo stacioni i fundit. Nëse dëshirojnë të bëjnë diçka tjetër më vonë, mund të vazhdojnë studimet ose të ndjekin një drejtim tjetër. Si prindër duhet t'i tërheqim mbrapsht dëshirat tona për profesionin e fëmijëve dhe t'i lëmë ata të vendosin vetë.

Dominique Heller, elektricist me përvojë, punon si moderator në radio

Prindërit e mi kanë gjetur kombinimin e duhur midis "lënies së kohës" dhe "nxitjes". Për një kohë të gjatë nuk po vendosja për një formim profesional, ndaj prindërit e mi më ndihmuan duke më dhënë ide. Sot unë punoj në një profesion tërësisht të ndryshëm. Sepse edhe nëse marrim një vendim në moshë të re, mund të ndryshojmë sërish drejtim.

Kathrin Marti, punon si infermiere

Gjatë orientimit profesional u kemi qëndruar gjithmonë pranë fëmijëve tanë. I kemi inkurajuar ata të ndjekin praktika mësimore. I kemi ndihmuar ata gjatë organizimit, duke krijuar kontakte me miqtë tanë që punojnë në profesionin e tyre të dëshiruar. Edhe kur fëmijët kanë pasur pyetje, i kemi ndihmuar sa mundeshim. Atje ku nuk i ndihmonim dot, i jemi drejtuar këshillimit profesional.

Claudia Graf, punon si kimiste

Prindërit e mi më kanë motivuar dhe mbështetur të përfundoja edhe klasën e 10të. Viti i ndërmjetëm ishte shumë i rëndësishëm për mua, për t'u rritur, për t'u marrë intensivisht me orientimin profesional dhe përgatitjet përkatëse. Gjatë këtij viti isha e fiksuar me një profesion të vetëm. Mamaja më ka ndihmuar të hap horizonte të reja e të shoh edhe profesione të tjera. Ajo më motivoi të ndiqja një praktikë orientuese për profesionin e kimistes. Unë vetë nuk do e kisha zgjedhur asnjëherë. Tani jam e bindur që kam mësuar profesionin e përshtatshëm për mua dhe se kam ndjekur rrugën e duhur.

Luc Février, punon si informaticien

Prindërit më kanë mbështetur gjatë kërkimit të një vendi për praktikën orientuese. Edhe më pas, familja më ka ndihmuar në përpilimin e CV-së dhe në aplikimet që kam bërë. Nëse kam marrë vendimin e duhur, kjo ka qenë falë këshillave dhe mbështetjes së prindërve dhe miqve të mi gjatë kësaj kohe vendimtare për mua.

Michel Zwahlen, punonjës shitjesh, punon në procesimin e porosive, shitjet dhe në shërbimin e klientit

Ndonjëherë njeriu nuk duhet të kërkojë kaq shumë, pasi edhe një hobi mund të kthehet në një profesion. Hobi im më i madh ka qenë dhe është sporti i Hockey mbi akull, ndaj ndoqa një kurs profesional për shitjet dhe sot punoj në një biznes që merret me Hockey mbi akull. Duke pyetur e duke u interesuar njeriu mund të gjejë një vend pune të përshtatshëm edhe brenda hobit të tij.

Sylvie Meyer, punon si lektore në një fakultet profesional

Pas zgjedhjes së degës profesionale, duhet menduar për gjetjen e një vendi praktike mësimore: Një detyrë e vështirë për prindërit dhe të rinjtë. Për këtë, mund të ndihmojë një këshillim për intervistat e aplikimit dhe praktikat orientuese. Së fundi, pas hyrjes në praktikën mësimore, duhet parë nëse të rinjtë ndjehen mirë, pasi bota e punës është shumë më e ashpër sesa shkolla. Ajo që i ka ndihmuar më shumë fëmijët e mi, ka qenë koha që kanë pasur në dispozicion, për të përfunduar një vit mësimor ndërmjetës dhe për të shkuar në një vend ku flitet një gjuhë tjetër.

René Zahno, punon si këshilltar profesional dhe studimor

Për të gjetur një vend të përshtatshëm për praktikën mësimore, sot është e nevojshme të bësh shumë praktika orientuese, testime dhe aplikime. Krahas rezultateve shkollore, trajnuesit profesionalë vlerësojnë edhe sjelljen, motivimin dhe angazhimin. Një praktikë mësimore të jep mundësinë t'i prezantosh të gjitha këto cilësi.

FAQET E INTERNETIT

Berufsbildungplus.ch: Rubrika Formimi profesional bazë informon për shkallët e ndryshme të botës së punës, tregon shtatë hapat drejt profesionit dhe ofertat e ndryshme të këshillimit. **www.berufsbildungplus.ch**

Berufsberatung.ch: Portali për orientimin profesional, studimet dhe çështjet e karrierës ofron gjithë informacionet e nevojshme për orientimin profesional, edhe për prindërit e të rinjve në moshën e orientimit profesional. **www.berufsberatung.ch**

Missionfuture.ch: Nxënësit tregojnë përvojat e tyre të orientimit profesional dhe mbi murin e shënimeve mund të ngrihen pyetje. Të dyja këto mënyra tregojnë në formë loje drejtimet e ndryshme profesionale. Lista e linkeve vjen sërish në ndihmë për më tej. **www.missionfuture.ch**

Panairet e punës dhe formimit profesional: Një axhendë e organizimit të panaireve të punës dhe formimit profesional. **www.berufsbildungplus.ch** → Axhenda

SDBB: Këshilla për çështjet profesionale për prindërit, mjete ndihmëse dhe informacione për të rinjtë, revista për orientimin profesional, materiale për lëndën mësimore të orientimit profesional .
www.shop.sdbb.ch → Orientimi i parë profesional

VENDET E KËSHILLIMIT

Aargau

Beratungsdienste für Ausbildung und Beruf
Herzogstrasse 1, 5000 Aarau
Tel. 062 832 64 00
www.beratungsdienste-aargau.ch

Appenzell Ausserrhoden

Fachstelle Berufs-, Studien- und Laufbahnberatung
Regierungsgebäude, 9102 Herisau
Tel. 071 353 67 19
www.berufsberatung.ar.ch

Appenzell Innerrhoden

Amt für Berufsbildung und Berufsberatung
Hauptgasse 51, 9050 Appenzell
Tel. 071 788 93 70
www.ai.ch/de/verwaltung/aemter

Basel Land

Amt für Berufsbildung und Berufsberatung
Rosenstrasse 25, 4410 Liestal
Tel. 061 927 28 28
www.afbb.bl.ch

Basel Stadt

Basler Berufsinformation
Rebgasse 14, 4058 Basel
Tel. 061 267 86 92
www.bbe-bs.ch

Bern

Zentralstelle für Berufs-, Studien- und Laufbahnberatung
Bremgartenstrasse 37, Postfach, 3001 Bern
Tel. 031 633 81 00
www.be.ch/berufsberatung

Freiburg

Amt für Berufsberatung und Erwachsenenbildung, Rue St-Pierre Canisius 12
1700 Freiburg
Tel. 026 305 41 86
www.berufsberatungfr.ch

Genf

Office pour l'orientation, la formation professionnelle et continue
Rue Prévost-Martin 6, case postale 192
1211 Genève 4
Tel. 022 388 44 00
www.geneve.ch/ofpc

Glarus

Berufs- und Laufbahnberatung
Gerichtshausstrasse 25, 8750 Glarus
Tel. 055 646 62 60
www.biz-gl.ch

Graubünden

Amt für Berufsbildung
Rohanstrasse 5, 7000 Chur
Tel. 081 257 27 72
www.berufsbildung.gr.ch

Jura

Centre d'orientation scolaire et professionnelle et de psychologie scolaire
Chemin des Arquebusiers
2900 Porrentruy
Tel. 032 420 34 70
www.jura.ch/cos

Luzern

Berufs-, Studien- und Laufbahnberatung
Obergrundstrasse 51, 6002 Luzern
Tel. 041 228 52 52
www.biz.lu.ch

Neuenburg

Office cantonal de l'orientation scolaire et professionnelle
Rue du Parc 53, 2300 La Chaux-de-Fonds
Tel. 032 889 69 59
www.ne.ch/orosp

Nidwalden

Berufs- und Studienberatung
Robert-Durrer-Strasse 4, 6371 Stans
Tel. 041 618 74 40
www.netwalden.ch

Obwalden

Berufs- und Weiterbildungsberatung
Brünigstrasse 178, 6061 Sarnen
Tel 041 666 63 44
www.berufsberatung-ow.ch

Schaffhausen

Berufs-, Studien- und Laufbahnberatung
Herrenacker 9, 8201 Schaffhausen
Tel. 052 632 72 59
www.biz-sh.ch

Schwyz

Amt für Berufs- und Studienberatung
Huobstrasse 9, 8808 Pfäffikon
Tel. 055 417 88 99
www.sz.ch/berufsberatung

Solothurn

Berufs- und Studienberatung
Bielstrasse 102, 4502 Solothurn
Tel. 032 627 28 90
www.biz.so.ch

St. Gallen

Zentralstelle für Berufsberatung
Davidstrasse 31, 9001 St. Gallen
Tel. 058 229 20 46
www.berufsberatung.sg.ch

Tessin

Ufficio dell'orientamento scolastico e professionale
Stabile Torretta, Viale Franscini 32
6501 Bellinzona
Tel. 091 814 63 51
www.ti.ch/uosp

Thurgau

Berufs- und Studienberatung
Am Marktplatz, St.Gallerstrasse 11
8510 Frauenfeld
Tel. 052 724 13 81
www.abb.tg.ch

Uri

Berufs-, Studien- und Laufbahnberatung
Klausenstrasse 4, 6460 Altdorf
Tel. 041 875 20 62
www.ur.ch/berufsberatung

Waadt

Office cantonal d'orientation scolaire et professionnelle
Rue de la Borde 3d, 1014 Lausanne
Tel. 021 316 11 70
www.vd.ch/orientation

Wallis

Amt für Berufs-, Studien- und Laufbahnberatung Oberwallis
Schlossstrasse 30, 3900 Brig-Glis
Tel. 027 922 48 80
www.vs.ch/berufsberatung

Office d'orientation scolaire et professionnelle du Valais romand
Avenue de France 23, 1950 Sion
Tel. 027 606 45 00
www.vs.ch/orientation

Zug

Amt für Berufsberatung
Baarerstrasse 21, 6300 Zug
Tel. 041 728 32 18
www.zug.ch/biz

Zürich

Amt für Jugend und Berufsberatung
Dörflistrasse 120, 8090 Zürich
Tel. 043 259 96 00
www.berufsberatung.zh.ch

BOTIME DERI MË SOT

Numri 1: Fokusi - Arsimi i lartë profesional*
Numri 2: Fokusi - Vlera formuese e praktikës*
Numri 3: Fokusi - Pjekuria profesionale*
*e disponueshme në gjermanisht, frëngjisht dhe italisht.